

EKONOMI DHE FINANCË

PRODUKTIVITETI: THEMBRA E AKILIT E EKONOMISË SHQIPTARE

Selami Xhepa
Ornela Liperi
Gusht 2021



Treguesit e ulët të konkurrueshmërisë dëshmojnë për një nivel të dobët të produktivitetit të ekonomisë shqiptare.



Vendi ka një mungesë të theksuar të dijes produktive, që përbën dhe faktorin kryesor të rritjes ekonomike nëpërmjet zhvillimit të produkteve dhe sektorëve të rinj.



Ky nivel modest produktiviteti mund të jetë pasojë e niveleve të ulëta të investimeve në teknologji dhe kapital njerëzor dhe e eficiencës me të cilën përdoren këto burime të kufizuara ekonomike.

STUDIM

PRODUKTIVITETI: THEMBRA E AKILIT E EKONOMISË SHQIPTARE



Programi «Economy for All» është një iniciativë e Fondacionit «Friedrich Ebert» që synon të ridimensionojë rolin e aktorëve ekonomikë dhe shoqërorë për të hedhur bazat e krijimit të një modeli të ri social-ekonomik. Iniciativa e FES-it mbështetet plotësisht në ekspertizën e anëtarëve të grupit të ekspertëve, të cilët gjithashtu kanë reflektuar mbi studimin që ju tashmë keni në dorë.

FES-i falënderon grupin e punës të «Economy for All»: Adrian Civici, Daniel Guçe, Irena Beqiraj, Ornela Liperi dhe Selami Xhepa, për angazhimin e plotë dhe vullnetin e mirë për një investim serioz drejt një modeli social-ekonomik për vendin tonë.

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1. PARASHTRIMI I PROBLEMIT DHE NJË SHFLETIM I LITERATURËS MBI PRODUKTIVITETIN DHE RITJEN EKONOMIKE	5
2. MJEDISI EKONOMIK DHE NDIKIMI I PANDEMISË	8
3. STRUKTURA EKONOMIKE DHE PRODUKTIVITETI	12
4. CILA ËSHTË GATISHMËRIA TEKNOLOGJIKE E FIRMAVE SHQIPTARE? A INVESTOJNË ATO NË TEKNOLOGJITË E REJA?	16
5. A INVESTOJNË FIRMAT LOKALE NË TEKNOLOGJI MË TË PËRPARUARA PËR TË REALIZUAR PRODUKTE DHE SHËRBIME MË TË SOFISTIKUARA DHE KOMPLEKSE?	22
6. POLITIKAT PUBLIKE TË DERISOTME NË MBËSHTETJE TË TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJISË DHE TË ASISTENCËS SË BIZNESIT NË INOVACION	26
7. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	28
LITERATURA MBËSHTETËSE	30
ANEKSI 1: TË DHËNA PËR POPULLATËN E INTERVISTUAR	31
ANEKSI 2: PYETËSORI	33

Përmbledhje ekzekutive

Qëllimi i këtij materiali është të hetojë mbi problematikën e produktivitetit të ekonomisë së vendit dhe politikat më të përshtatshme që mund të ndikojnë në rritjen e tij. Specifikisht, ne jemi të interesuar rreth arsyeve kryesore përse biznesi privat prodhues lokal ka mbetur i ngërthyer në një nivel modest produktiviteti. Gjendja e dobët e produktivitetit dëshmohet nga treguesit e ulët të konkurrueshmërisë së ekonomisë, veçanërisht në dimensionet e lidhura me sofistikimin e biznesit, kulturën e biznesit dhe aktivitetet e kërkim-zhvillimit. Po kështu, Indeksi i Kompleksitetit Ekonomik e rendit Shqipërinë disa shkallë më poshtë se vendet e rajonit, duke dëshmuar se vendi ka një mungesë të theksuar të dijes produktive, që përbën dhe faktorin kryesor të rritjes ekonomike nëpërmjet zhvillimit të produkteve dhe sektorëve të rinj. Duke përdorur të dhënat parësore të gjeneruara nëpërmjet anketimit të biznesit prodhues dhe analizën e të dhënave dytësore të disponueshme, disa nga gjetjet kryesore të këtij punimi janë:

- a. Pësia më e madhe e investimeve në teknologji ka shkuar vetëm në sektorët tradicionalë dhe për prodhimin e produkteve tradicionale. Investimet nuk e kanë transformuar strukturën prodhuese të vendit dhe kalimin drejt industrive të niveleve të larta të vlerës së shtuar dhe produktivitetit të lartë.
- b. Sektorët ku është investuar më shumë në teknologji kanë treguar një nivel produktiviteti prej 50% deri në dy herë më të lartë se niveli mesatar i produktivitetit të ekonomisë. Ndërsa në sektorët ku ka pasur më pak investime, produktiviteti qëndron rreth 30–80% më i ulët

se produktiviteti mesatar i ekonomisë. Kjo do të thotë se investimi shpërblen dhe se është në interes të firmave që dëshirojnë të sigurojnë norma më të larta fitimi të angazhohen në një proces investimesh modernizuese të teknologjisë dhe dijes.

- c. Anketimet tregojnë se vetë biznesi është i ndarë për sa i takon interesit investues për të qenë më konkurrues në tregje. Dy drejtimit kryesore të investimeve që ata shohin me prioritet janë investimet në teknologji të reja dhe në zhvillim produktesh të reja. Problemi kryesor që ata evidentojnë në pamundësinë për investime lidhet me aksesin në financa.
- d. Shqetësuese janë gjithashtu dy gjetje të studimit:
 - (i) investimet në burime njerëzore nuk konsiderohen po aq të rëndësishme sa ato në teknologji dhe në zhvillim produktesh. Ndërkohë në debatet e përditshme mediatike nënvizohet se mungesa e burimeve njerëzore të kualifikuara është dhe një nga pengesat kryesore të biznesit.
 - (ii) një segment shumë i gjerë i biznesit nuk është i interesuar të investojë në teknologji të reja. Ky segment duket se është i kënaqur me situatën e një biznesi që ruan statukuonë, pa u interesuar të ndryshojë dinamikën e prodhimit dhe të tregjeve në të cilat punon.

Këto dyshqetësime të konstatuara nga studimi konfirmojnë se problemi i konkurrueshmërisë së ekonomisë është një problem sa kulturor, po aq edhe financiar.

1

PARASHTRIMI I PROBLEMIT DHE NJË SHFLETIM I LITERATURËS MBI PRODUKTIVITETIN DHE RITJEN EKONOMIKE

Rritja ekonomike ka qenë forca kryesore për progresin material të shoqërisë njerëzore. Teoria që shpjegon faktorët e rritjes ka evoluar gjatë dekadave të kërkimeve më të thelluara, që prej studimeve të para pioniere të ndërmarra qysh në fillimet e shekullit të njëzetë. Për ta paraqitur në mënyrë shumë sintetike këtë rrugëtim, në fillimet e veta teoria nënvizonte se burimi i rritjes ekonomike ishte “më shumë kapital, më shumë punë”. Por, kontributi i rritjes së këtyre faktorëve në rritjen e prodhimit bëhet me një normë gjithnjë e më rënëse, nëse nuk gjenden mënyra më të mira të përdorimit të burimeve. Rober Solow zbuloi se “më shumë punë dhe më shumë kapital” shpjegonte vetëm 14% të rritjes; 86% tjetër mbetej pa shpjegim. Kjo u quajt “X-efficiency” ose efienca e përdorimit të faktorëve të prodhimit, që, në thelb, është raporti i faktorëve të përdorur ndaj potencialit total të faktorit. Ky është, pra, dhe produktiviteti i përdorimit të faktorëve.

Në fakt, produktiviteti është motori final, elikziri i rritjes ekonomike, dhe, për këtë arsye, rritja e produktivitetit shihet si sfida kryesore e ekonomisë botërore. Në shkallë globale, pas ritmeve të forta të rritjes që u shënuan në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, produktiviteti filloi të bjerë dukshëm në fund të viteve 1970. Kjo prirje rënëse ndryshoi në vitet 1990, si pasojë e thellimit të globalizimit dhe zgjerimit të tregtisë botërore, si dhe e niveleve të larta të investimeve në teknologjitë e reja dhe proceset inovative të biznesit. Zhvillimet teknologjike të botës, veçanërisht pas viteve 2000, me fillimin e Revolucionit të Katërt Industrial, bënë që pritshmëritë për rritjen e produktivitetit të ishin mjaft të larta. Sidoqoftë, siç e thekson një studiu, deri tani revolucioni i ri teknologjik duket kudo përveçse në treguesit e produktivitetit. Kriza financiare e vitit 2008 i dha një goditje negative edhe produktivitetit. Që pas kësaj periudhe është vërejtur një rënie e përhershme e ritmeve të rritjes së produktivitetit, e cila, sipas Bankës Botërore, ka prekur 70% të ekonomive të botës. Tashmë ekonomia botërore ka hyrë në një fazë të njohur si epoka e “rritjes sekulare” (norma të ulëta rritjeje dhe norma të ulëta interesi), gjë që e bën problemin e produktivitetit faktor kyç në zhvendosjen e ekonomisë në një kurbë të ritmeve të larta të rritjes.

Si rrjedhojë, kërkimet mbi përcaktuesit e produktivitetit janë të shumta dhe të vazhdueshme. Një shqyrtim i plotë i kërkimeve për gjithë periudhën 1990–2015, i kryer nga Kim dhe Loayza (2017)¹, i klasifikon në pesë kategori faktorët që përcaktojnë produktivitetin:

- Inovacioni: krijimi (ose/dhe adoptimi) i teknologjive të reja që përmirësojnë performancën e aktiviteteve ekzistuese;
- Arsimi: përparimi i dijes dhe formimi i aftësive të duhura për adoptimin dhe përdorimin e teknologjive, ndryshimet e nevojshme organizative dhe proceset e prodhimit dhe të tregtimit;
- Efienca e tregut: alokimi eficient dhe në kohë i burimeve të kapitalit njerëzor dhe fizik, ku përfshihen gjithashtu natyra dhe cilësia e rregullimeve ligjore;
- Infrastruktura fizike: energjia, transporti, aksesit në rrjetin ujor dhe sanitar, rrjeti IT dhe pjesë të tjera të infrastrukturës së prekshme;
- Infrastruktura institucionale: qeverisja ekonomike dhe një kuadër ligjor miqësor për biznes dhe sipërmarrje janë kritike për produktivitetin dhe rritjen. Ky variabël ka marrë një vëmendje të shtuar veçanërisht gjatë dekadave të fundit me një sërë punimesh të kryera nga një numër autorësh influencues (shih, për shembull: Hall dhe Jones (1999); Easterly dhe Levine (2003); Acemoglu, Johnson dhe Robinson (2004); Rodrik, Subramanian dhe Trebbi (2004)).

Studimet e fundit nënvizojnë se problemi i produktivitetit do të bëhet edhe më shqetësues pas ndikimeve të pandemisë së COVID-19-s. Sipas një kërkimi të Bankës Botërore (2020), vendet e prekura nga shpërthimet

¹ Young Eun Kim, Norman V. Loayza, 2017, Productivity and its Determinants: Innovation, Education, Efficiency, Infrastructure, and Institutions, World Bank working paper.

pandemike në shekullin e 21-të (pa përfshirë COVID-19-n), tri vite pas pandemisë shënuan një rënie prej 9% të produktivitetit të punës krahasuar me vendet që nuk ishin prekur prej tyre.²

Shqetësimi mbi produktivitetin bëhet më serioz për ekonomitë e vendeve në zhvillim si Shqipëria, e cila vijon të zhgënjë në mënyrë sistematike në treguesit e produktivitetit. Siç del nga analiza krahasuese, produktiviteti në Shqipëri rezulton të jetë rreth 36% më i ulët se në Maqedoninë e Veriut dhe mbi 56% më i ulët se në Serbi.

Në një material studimor³ të Qendrës për Zhvillim Ndërkombëtar (*Center for International Development* (CID)) të Universitetit të Harvardit, thuhet se, "pavarësisht nga çështjet serioze në shumë fusha të tjera, evidencat tregojnë se kufizimi detyrues (*binding*) ndaj rritjes së fortë ekonomike në Shqipëri është mungesa e "dijes produktive" (*productive know-how*), domethënë e njohurive dhe aftësive që kërkohen për të prodhuar mallra dhe shërbime

komplekse." Nga ana tjetër, investimet e pamjaftueshme në zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe në teknologjitë e reja e kanë thelluar hendekun me vendet më të zhvilluara dhe më të sofistikuar nga ana teknologjike.

Një mori indikatorësh që matin shkallën e sofistikimit të bizneseve, inovacionin, aktivitetet e kërkim-zhvillimit etj., mbeten në nivele shqetësuese prej kohësh dhe me një renditje nën vendet fqinje. Në Raportin e Konkurrueshmërisë Globale të vitit 2019, Shqipëria renditej në vendin e 110-të (nga 140 vende) për sa i përket kapacitetit të ekonomisë për inovacion. Në fakt, indikatorët e konkurrueshmërisë së ekonomisë mbeten problematikë prej vitesh, siç dëshmohet në të dhënat e tabelës 1.

CID-i ka ndërtuar një Indeks të Kompleksitetit Ekonomik⁴ për matjen e *know-how*-t produktiv, ku rezulton se, në raport me të ardhurat, ky indeks është më i ulët dhe, që prej vitit 2005, kur ai ka filluar të llogaritet, Shqipëria

Tabela 1:

Indikatorët e konkurrueshmërisë

	10	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Indikatori i përgjithshëm	98	108	96	88	89	95	97	93	80	75	76	81
Institucionet	108	109	87	63	84	118	103	84	76	68	68	76
Infrastruktura	121	121	104	89	91	99	90	88	91	94	100	98
Adoptimi i TIK-ut	104	92	89	72	77	92	91	89	82	78	74	75
Stabiliteti Makro	83	96	95	101	98	94	122	118	93	75	97	104
Shëndeti	34	69	66	56	79	56	62	52	33	36	45	46
Aftësitë për punë	92	97	90	84	76	78	60	47	42	49	47	50
Tregjet e prodhimit (eficienca)	109	119	97	63	58	97	93	63	69	57	58	75
Tregu i punës	na	67	65	63	68	67	93	97	98	91	34	38
Sistemi financiar	na	103	90	100	120	128	114	118	94	81	105	102
Madhësia e tregut	na	106	106	103	98	107	105	104	109	105	108	111
Dinamizmi i biznesit (sofistikimi)	115	123	109	87	98	122	104	95	94	74	48	63
Kapaciteti për inovacion	125	132	126	121	123	119	120	118	109	87	91	110
Kultura sipërmarrëse												111
R&D												126
Numri i vendeve	131	134	133	139	144	144	148	140	138	137	140	141

Burimi: Ndërtuar me të dhënat e botimeve vjetore të Raportit të Konkurrueshmërisë Globale

2 Alistair Dieppe, 2020, Global Productivity: Trends, Drivers, Policies, World Bank 2020

3 Tim O'Brien et al., 2017, What is the Binding Constraint to Growth in Albania?, Center for International Development, Harvard University, 2017. Universiteti i Harvardit është përzgjedhur nga qeveria shqiptare të shërbejë si këshilltar për politikat e zhvillimit ekonomik të vendit që prej vitit 2014.

4 Indeksi i kompleksitetit ekonomik është një lidhje midis dijes që zotëron një shoqëri dhe aktivitetit ekonomik që ajo realizon. Produktet e sofistikuar dhe inovatore janë shprehje e nivelit të dijes së shoqërisë. Duke qenë se burimet e fitimeve dhe të rritjes ekonomike vijnë pikërisht nga aktivitetet të tilla, konsiderohet gjerësisht se vlera e këtij indeksi është një parashikues më i mirë i rritjes ekonomike (por dhe i pabarazive) se indekset e tjera të konkurrueshmërisë së ekonomisë.

ruan vlerën më të ulët në rajon. Bazuar në këtë indeks, nga 133 ekonomi të studiuar, në vitin 2018 Shqipëria renditej në vendin e 76-të, Maqedonia e Veriut në vendin e 57-të, Serbia në vendin e 38-të dhe Bosnjë-Hercegovina në vendin e 37-të.

Kjo do të thotë se, nëse këta tregues që matin konkurrueshmërinë e ekonomisë dhe aftësinë e saj për të prodhuar produkte më komplekse dhe me vlerë të shtuar më të lartë, do të vazhdojnë të dominojnë në ekonomi edhe në dekadat e ardhshme, procesi i konvergencës së të ardhurave nuk do të arrihet as në një shekull, e madje, nëse firmat shqiptare do të vazhdojnë të mbeten po kaq të mbyllura përballë përparimit teknologjik që po ecën me ritme shumë të forta, ky hendek mund të thellohet. “Kjo strukturë prodhimi, – konkludon raporti i CID-it, – tregon se nuk mund të mbështetet një rritje të qëndrueshme.”

Nisur nga ky kontekst, ne kemi synuar të hetojmë pak më thellë mbi shkaqet që e mbajnë ekonominë tonë të ngërthyer në këtë “ekuilibër të keq”: mungesë inovacioni – fitime të ulëta⁵ sot – perspektivë e pasigurt për të ardhmen. Një numër pyetjesh shtrohen në këto rrethana: Pse firmat vendase duket se nuk investojnë në zbatimin e teknologjive të përparuara dhe krijimin e incentivave të mjaftueshme për krahun e punës, si burime kryesore të rritjes së produktivitetit dhe suksesit tregtar në afat të gjatë? A ofron biznesi privat nxitje të mjaftueshme për punonjësit, në mënyrë që puna (dhe kapitali) të bëhet më produktive? Pse nuk ndodh ky transferim i dijës së kompleksitetit të produkteve dhe shërbimeve? A mjaftohen sipërmarrësit lokalë me fitimet e sotme dhe nuk kanë interes të mendojnë për qëndrueshmërinë e biznesit në afat të gjatë? Problemi qëndron te teknologjia apo tek aftësitë dhe kualifikimet e pamjaftueshme të forcës së punës? A ofron sistemi aktual institucional ligjor nxitje të mjaftueshme për të promovuar përparimin teknologjik në ekonomi? Pse disa nga vendet e rajonit kanë filluar të bëjnë një ndryshim cilësor, ndërsa Shqipëria qëndron shumë poshtë tyre? Çfarë mekanizmesh apo politikash kanë zbatuar këto vende dhe a mund të replikohen ato edhe nga vendi ynë? A ka eksperimentuar Shqipëria me skema dhe instrumente të dedikuara për transferim teknologjik dhe inovacion, dhe pse këto nuk kanë arritur të sjellin një ndryshim?

Mbi këto pyetje të shtruar do të përpiqemi të hetojmë, duke u bazuar kryesisht në analizën e të dhënave të grumbulluara nga vetë firmat. Nga pikëpamja metodologjike, në punim do të përdoren si të dhënat dytësore të nxjerra nga botimet e enteve shtetërore të informacionit (kryesisht INSTAT-i), dhe të dhënat parësore të grumbulluara nëpërmjet një pyetësori të hartuar për këtë qëllim. (Aneksi 1 jep një përshkrim të karakteristikave të popullatës së përfshirë në analizë.)

Studimi i Harvardit, që është më i fundit dhe trajton specifikisht problemin në fjalë, këtë mungesë përpjekjesh për sofistikim e përparim teknologjik dhe këtë mangësi transferimi të dijeve ua atribuon së kaluarës historike të vendit dhe diversifikimit të kufizuar që ka ndodhur në strukturën ekonomike gjatë tri dekadave të tranzicionit. Kjo do të thotë se problemi është kryesisht kulturor dhe për kapërcimin e tij duhen zbatuar instrumente të ndryshme nga ato që do të mund të zbatoheshin nëse problemi do të qëndronte te nxitjet ekonomike apo te kuadri institucional. Është gjithashtu ndjesia e autorëve nga kontaktet e shpeshta me industrinë dhe shoqatat e bizneseve, se problemi kulturor është një prej problemeve serioze dhe shpjegon në një masë të madhe gjendjen e dobët të konkurrueshmërisë së matur me këto dimensione. Sidoqoftë, me instrumentet dhe politikat e duhura publike, gjendja mund të ndryshojë. Siç e evidenton dhe vetë studimi i CID-it, eksperiencia të suksesshme ndeshen në disa industri (vaji i ullirit dhe përpunimi i mishit), të cilat janë mbështetur me projekte të huaja (USAID dhe GIZ). Kjo do të thotë se, nëse autoritetet publike do të hartojnë programet e duhura për transferim teknologjie dhe rritje të aftësimin të punonjësve, atëherë gjendja mund të ndryshojë edhe në sektorë të tjerë të ekonomisë.

Pandemia e COVID-19-s ka krijuar një dinamikë dhe një perspektivë të re për sipërmarrjen. Roli i teknologjisë po merr më shumë vëmendje dhe po konsiderohet gjithnjë e më shumë si një alternativë kryesore në strategjitë e firmave për të rritur konkurrueshmërinë. Normaliteti i ri i krijuar nga distancimi social i ka shtyrë firmat të kërkojnë se si teknologjitë mund t’u vijnë në ndihmë për të kapërcyer rreziqet sot, por dhe se si të përshtaten në të ardhmen.

5 Këtë nënkupton teoria ekonomike, dhe ne abstragojmë nga fitimet reale të firmave, të cilat, në mungesë të konkurrencës, mund të sigurojnë renta të larta për firmat, por ndikimet në ekonomi janë me pasoja negative serioze pasi pengojnë përpjekjet për inovacion, çka përbën edhe objektin e kërkimit tonë.

2

MJEDISI EKONOMIK DHE NDIKIMI I PANDEMISË

Përkundër një rritjeje ekonomike përgjithësisht të dobët që ka karakterizuar ekonominë gjatë viteve të fundit, qysh nga kriza globale e vitit 2008, duket se firmat prodhuese kanë gëzuar një mjedis ekonomik relativisht dinamik.

Bazuar në intervistat e kryera me firmat prodhuese, deri përpara pandemisë, më shumë se 67% e tyre kanë raportuar rritje të shitjeve mbi 10%, madje 1 në 5 firma raportojnë rritje të shitjeve mbi 20%. Ngjashmërisht, siç evidentohet nga grafikët përkatës, rritje mjaft të fortë kanë shënuar edhe indikatorët e fitimeve dhe të punësimit. Nga ana tjetër, gati 1/3 e firmave kanë raportuar rënie si të shitjeve, dhe të fitimeve, çka e bën mjedisin e biznesit sfidues për një numër jo të vogël biznesesh lokale.


Pandemia e shkaktuar nga COVID-19-a dhe mbyllja e aktiviteteve ekonomike ishin goditje të rënda për këto dinamika pozitive. Duke përjashtuar një numër të vogël firmash që shënuan rritje të shitjeve (6%) apo që nuk regjistruan ndonjë efekt (19%), kryesisht në sektorët e

imunizuar nga efektet e mbylljes, më shumë se 70% e firmave prodhuese u goditën seriozisht. Rënia e shitjeve ishte ndikimi kryesor i pandemisë, që është i kuptueshëm për shkak të mbylljes së plotë të rrugëve tregtare dhe riprioritarizimit të modeleve të konsumit në ekonomi të diktuar nga gjendja e pasigurive të krijuara. Ndërkohë, është interesant fakti se një numër shumë i vogël firmash kanë shënuar rritje të kostove, vështirësi në furnizimin me lëndë të para, apo pezullim të aktivitetit prodhues. Madje rreth 20% e firmave deklarojnë se nuk kanë pasur asnjë ndikim nga pandemia, ndërsa vetëm 6% deklarojnë se kanë pasur rritje të shitjeve.


Këto të dhëna përforcojnë konkluzionin se ndikimet e pandemisë nuk kanë qenë të njëjta për të gjitha industritë dhe segmentet e bizneseve. Disa industri kanë regjistruar rritje të forta të shitjeve dhe fitimeve, si pasojë e ndryshimeve në modelet e konsumit të popullatës.

Grafiku 1:


Pikëpamja e biznesit mbi qarkullimin ekonomik gjatë pesë viteve të fundit



Grafiku 2:

Pikëpamja e biznesit mbi fitimet gjatë pesë viteve të fundit


Grafiku 3:

Pikëpamja e biznesit mbi punësimin gjatë pesë viteve të fundit

Pritshmëritë për të ardhmen konsiderohen si optimiste të moderuara. Më shumë se 60% e bizneseve presin që në pesë vitet e ardhshme të shënojnë një rikthim të ritmeve të biznesit në nivelet përpara pandemisë. Por gati 1/3 e tyre nuk presin ndryshime të biznesit as në treguesit e

shitjeve, të fitimit dhe të punësimit. Madje në treguesit e punësimit të ardhshëm, pritjet e biznesit janë edhe më të zymta. Gati gjysma e tyre nuk kanë pritshmëri për rritje punësimi.

Grafiku 4:
Pikëpamja e biznesit mbi ndikimet e pandemisë në biznes




Duke përmblodhur këtë seksion të analizës mbi perceptimet e biznesit për efektet e pandemisë së COVID-19-s dhe pritshmëritë e tyre për të ardhmen, mund të nënvizojmë se: (a) ndikimet e pandemisë kanë qenë të forta, por afatshkurtra. Firmat nuk kanë raportuar për probleme në kanalet e furnizimit me lëndë të para apo presione për rritje të kostove. (b) rikthimi i bizneseve


në gjendjen e parapandemisë mund të ndodhë shpejt, megjithatë, optimizmi duket i përmbajtur, duke dëshmuar se pasiguritë për të ardhmen janë akoma të larta.

Kërkimet kanë treguar se zgjidhjet digjitale kanë luajtur një rol kritik në mbajtjen e industrive në aktivitet dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme publike edhe gjatë mbylljes nga


Grafiku 5:
Pikëpamja e biznesit mbi qarkullimin ekonomik gjatë pesë viteve të ardhshme



Grafiku 6:
Pikëpamja e biznesit mbi fitimet gjatë pesë viteve të ardhshme



Grafiku 7:
Pikëpamja e biznesit mbi punësimin gjatë pesë viteve të ardhshme



pandemia. Ky aksident historik i pandemisë po ndryshon perceptimin e biznesit (dhe të shoqërisë në tërësi) për rolin që mund të luajë digjitalizimi në të ardhmen, duke përshejtuar planet e industrive në automatizimin dhe digjitalizimin e proceseve të prodhimit dhe tregtimit. Para

se të paraqesim perspektivën e vetë biznesit mbi rolin e teknologjive në të ardhmen e veprimtarisë së tyre, po ndalemi në përpjekjet e këtyre tri dekadave tranzicioni për rinovimin e stokut teknologjik në ekonomi në tërësi.

3

STRUKTURA EKONOMIKE DHE PRODUKTIVITETI


Siç e nënvizon edhe studimi i CID-it, struktura ekonomike e vendit, qoftë e parë në këndvështrimin e dominimit të sektorëve tradicionalë të vlerës së shtuar të ulët, por edhe në këndvështrimin e popullatës së firmave, të dominuar nga mikrondërmarrje të cilat kanë mundësi të kufizuara për inovacion dhe sofistikim, është një nga problemet kyçe të nivelit të ulët të produktivitetit. Të dhënat zyrtare të INSTAT-it tregojnë se struktura e ekonomisë ka mbetur pothuajse e pandryshuar në dy dekadat e fundit. Në 2019-n, pesha e bujqësisë ishte rreth 18.4% e Prodhimit

të Brendshëm Bruto (PBB), pothuajse njëjloj si në 2005-n. Në rritje të lehtë ishte industria, gjithsej me gati 2 pikë përqindje më shumë se në 2015-n, duke arritur në 11.6%, përmirësim që ka ardhur më së shumti nga zgjerimi i industrisë së nxjerrjes së naftës (shfrytëzimi i burimeve natyrore të vendit).

Pesha e ndërtimit, që kulmoi në pjesën e parë të tranzicionit, erdhi në ulje ciklike deri në 2019-n, (nga 15% në 2015-n, në 8.6% në 2019-n), por po i rikthehet


Grafiku 8:

Struktura ekonomike e vendit: pesha e sektorëve në PBB, %



Burimi: INSTAT

Grafiku 9:

Ecuria e produktivitetit gjatë dekadës së fundit: shifra e afarizmit për të punësuar, në mijë lekë

Burimi: Anketa Strukturore, INSTAT

sërisht rritjes së shpejtë. Në 2020-n, vitin e krizës, pesha e tij u rrit në 9.2%, shifra më e lartë e regjistruar që nga viti 2013. Ndërtimi po tërheq kapitalet e lira dy vitet e fundit, duke shfrytëzuar dhe çlirimin e lejeve të ndërtimit pas 2018-s.

“Tregtia; transporti; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor”, një gjenerator kryesor i punësimit, vijon të kontribuojë me gati 17% të PBB-së.

Pesha e “Informacionit dhe komunikacionit” është ulur me 1.5 pikë përqindje në këta 14 vjet, pas maturimit të industrisë së telefonisë së lëvizshme, ndërsa “Aktivitetet financiare dhe të siguracionit” kanë mbetur në rreth 2% të PBB-së.

Nëse ka një aktivitet që ka lulëzuar, është ai i sipërmarrjes individuale të vetë njerëzve, sidomos në kategorinë e profesioneve të lira. “Aktivitetet shkencore, profesionale, administrative dhe mbështetëse”, që përfshijnë shërbime juridike dhe të kontabilitetit, aktivitete të drejtimit të ndërmarrjeve dhe aktivitete të konsultimit, aktivitete arkitekturore dhe inxhinierie; aktivitete të kontrolleve dhe analizave teknike, kërkim dhe zhvillim shkencor, sollën gati 7% të PBB-së në 2019-n, nga më pak se 2% në 2005-n.

Në rritje ka ardhur edhe pesha e argëtimit dhe çlodhjes, nga 1.5% në 2.3% të PBB-së.

Modeli ekonomik nuk rezulton të ketë nxitur produktivitetin. Sipas të dhënave të Anketës Strukturore të INSTAT-it, shifra e afarizmit vjetor për të punësuar për

të gjithë prodhuesit në treg në 2019-n ka rënë me 6.2% në krahasim me 2010-n. Në të njëjtën periudhë, numri i të punësuarve pothuajse u dyfishua. Ecuria tregon se bizneset kanë investuar më pak në teknologji dhe janë bazuar më shumë te kapitali intensiv i punës. Për të njëjtën periudhë, norma e fitimit për të gjithë prodhuesit në treg zbriti nga 12.2% në 8.4%.


Të dhënat krahasuese me dy shtete të rajonit, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, tregojnë se vendi ynë ka një ekonomi thuhet primitive. Shqipëria karakterizohet nga një numër i lartë mikrondërmarrjesh me një nivel produktiviteti tepër të ulët.

Në fund të vitit 2019, në vend ushtronin aktivitetin ekonomik 104 mijë ndërmarrje (pa përfshirë sektorin bujqësor), kundrejt 58 mijë në Maqedoninë e Veriut dhe 88 mijë në Serbi (me ekonomi dy herë më të madhe sesa Shqipëria).

Shifra vjetore e afarizmit për të punësuar (tregues i produktivitetit në ekonomi) për Shqipërinë ishte 35 mijë euro për vitin 2019, përkundrajt 55 mijë euro në Maqedoninë e Veriut dhe rreth 80 mijë euro në Serbi.

Pesha e sektorit të manufakturës në vendin tonë është dy herë më e ulët se në Maqedoninë e Veriut dhe 2.3 herë më e ulët se në Serbi. Për më tepër, sektori i manufakturës ekzistuese bazohet në punën e lirë dhe vlerën e ulët shumë të vogël, siç janë industritë e prerje-qepjes dhe të lëkurë-këpucëve. Siç e theksuam dhe më sipër, një strukturë e tillë e përball vendin me probleme të qëndrueshmërisë së rritjes ekonomike në afat të gjatë.

Grafiku 10:

Produktiviteti në tri vendet e rajonit, në euro për të punësuar


Burimi: Institutet statistikore, Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Serbi, përpunime të autorëve

Tabela 2:

Struktura ekonomike: pesha e sektorëve në vlerën e shtuar të ekonomisë, %

Viti 2018	Shqipëria	Serbia	Maqedonia e Veriut
A1 Bujqësi, pyje dhe peshkim	18,44	6,3	7,2
A2 Industria nxjerrëse	2,55	2	1,2
A3 Industria përpunuese	6,15	14,5	12,9
A4 Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	2,75	3,4	3,3
A5 Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	0,84	0,5	0,8
A6 Ndërtimi	8,99	4,5	6
A7 Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	10,75	11,5	11,3
A8 Transporti dhe magazinimi	3,27	3,9	3,9
A9 Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	2,38	1,4	1,9
A10 Informacioni dhe komunikacioni	2,85		2,9
A11 Aktivitete financiare dhe të siguracionit	2,28	3	2,9
A12 Aktivitete të pasurive të paluajtshme (Dhënies–Marrjes me qira)	5,49	7	9,1
A13 Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	3,2	3,9	4
A14 Aktivitete administrative dhe shërbime mbështetëse	3,3	2,3	
A15 Administrimi publik dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm	4,39	3,4	
A16 Arsimi	4,15	3,4	
A17 Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	2,96	3,9	
A18 Arte, argëtim dhe çlodhje	1,04	1,2	
A19 Aktivitete të tjera shërbimi dhe aktivitete të familjeve	1,67	1,4	

Burimi: Autorët, ndërtuar me të dhënat e INSTAT-it dhe të agjencive statistikore të vendeve përkatëse

Përkundër përpjekjeve për të modernizuar stokun teknologjik, Shqipëria rezulton sërish me një strukturë ekonomike që bazohet kryesisht në aktivitet të vlerës së shtuar të ulët: bujqësi, shfrytëzim i burimeve natyrore dhe ndërtimtari. Tabela 2 tregon diferencat strukturore mes tri vendeve të rajonit.

Si një konkluzion i kësaj çështjeje, mund të thuhet se Shqipëria investon burime të shumta financiare në përmirësimet teknologjike. Por fokusimi i përpjekjeve ka mbetur vetëm brenda sektorëve tradicionalë, pa arritur të ndryshojë në mënyrë të dukshme strukturën prodhuese të vendit.

4

CILA ËSHTË GATISHMËRIA TEKNOLOGJIKE E FIRMAVE SHQIPTARE? A INVESTOJNË ATO NË TEKNOLOGJITË E REJA?

Është fakt se vendi trashëgoi një prapambetje të theksuar teknologjike nga sistemi i ekonomisë së centralizuar. Edhe pse përkundrejt sakrificave të mëdha të shoqërisë duke ndjekur norma kursimi të larta në kurriz të konsumit, struktura ekonomike e krijuar gjatë asaj periudhe ishte larg të qenit e qëndrueshme në kontekstin e një ekonomie të hapur⁶. Prapambetja teknologjike e trashëguar ka ndikuar në shpejtësinë me të cilën strukturat e reja ekonomike të vendit, veçanërisht ato industriale, janë përshtatur me kushtet e konkurrencës në tregjet e hapura. Për pasojë, vendit i është dashur të investojë burime financiare të mëdha për rinovimin e stokut teknologjik. Importet e makinerive dhe pajisjeve kanë zënë përherë një peshë relativisht të konsiderueshme në strukturën e importeve.


Duke iu referuar periudhës 2005–2019, vendi ka importuar çdo vit mesatarisht rreth 100 miliardë lekë makineri e pajisje, një shifër që përbën mesatarisht 7.6% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB).

Siç dëshmojnë të dhënat e grafikut 1 dhe tabelës 2, trendet në importet e teknologjisë kanë qenë të luhatshme dhe janë ndikuar kryesisht nga periudhat e investimeve të rëndësishme në vend dhe koha kur firmat e huaja kontraktore kanë importuar teknologjitë e tyre për përfundimin e veprave.

Përkundrejt volumeve relativisht të larta të importeve teknologjike, prapambetja e dëshmuar e firmave tona në aspektet e gatishmërisë teknologjike dhe sofistikimit të

Grafiku 11:

Importe makineri e pajisje, % ndaj PBB-së



⁶ Në vitin 1990, pesha e industrisë në strukturën e prodhimit të brendshëm në Shqipëri ishte 58.4%, ndërsa në një vend shumë më të zhvilluar, si Polonia, ajo ishte vetëm 29%. Kjo tregon se struktura e ekonomisë së vendit ishte mjaft e deformuar dhe me një përqendrim të paprecedent tek investimi në industrinë e rënda, të cilat dolën krejtësisht joeficiente.

bizneseve mund të shpjegohet me alokimin e investimeve sipas sektorëve. Më shumë se 50% e totalit të investimeve të kryera u atribuohen sektorëve të ndërtimit, prodhimit të energjisë elektrike, tregtisë dhe industrisë nxjerrëse. Ndërtimi i rrugëve dhe qendrave rezidenciale e komerciale, hidrocentraleve të reja dhe shfrytëzimi i pasurive të

Tabela 3:

Statistikat deskriptive të importit të makinerive dhe pajisjeve, % të PBB-së:

Mesatarja	Minimale	Maksimale	Devijimi standard
7.61 %	3.60 %	8.91 %	1.55253

nëntokës, naftës, kromit, bakrit etj., kanë qenë sektorët me nivelet më të larta të investimeve. Ndërsa industritë e manufakturës (fabrikimi i metaleve, industria tekstile dhe e këpucëve, industria kimike dhe e plastikës), si dhe industritë e tjera përpunuese zunë vetëm 8% të totalit të investimeve. Pikërisht sektorët industrialë që përbëjnë shtyllën e një ekonomie moderne prodhuese, kanë nivelet më të ulëta të investimeve. Kjo është një tjetër dëshmi se baza industriale e vendit mbetet e pazhvilluar nga aspekti teknologjik.

Një problem tjetër është dhe struktura e investimit brenda firmave. Në totalin e investimeve të kryera në ekonomi, vetëm 40% janë në instalime dhe linja teknologjike ndërsa pjesa tjetër shkon për llojet e tjera të investimit (tokë, ndërtesa etj.). Gjithashtu, mesatarisht 55–65% e totalit të investimeve janë kryer nga firmat e mëdha (ato me më shumë se 50 punëtorë), të cilat mund të presupozohet se janë dhe pjesa më e rëndësishme në segmentin e biznesit ku mund të gjenerohen inovacionet dhe përmirësimet teknologjike


Tabela 4:

Investimet e kryera, sipas sektorëve, në milionë lekë


21 Investime gjithsej (mln lekë)										
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	% e investimeve ndaj totalit viti 2018
1 Të gjithë prodhuesit për treg	86,010	129,970	148,818	162,899	181,278	208,240	221,404	231,713	238,145	16.3
15 Ndërtimi	9,794	18,160	17,463	7,715	25,667	23,399	19,812	25,781	38,903	16.3
12 Energjia elektrike dhe gazi	8,204	24,104	14,067	26,643	51,053	51,095	87,445	46,979	37,000	15.5
17 Tregtia me shumicë	10,164	8,724	17,754	20,283	12,331	20,750	22,503	22,806	28,300	11.9
2 Industria nxjerrëse	18,790	29,486	30,070	28,692	38,237	24,569	6,188	30,389	18,528	7.8
13 Furnizimi me uje	669	1,530	5,341	859	1,236	6,864	5,728	22,537	15,769	6.6
18 Tregtia me pakicë	6,127	3,437	4,085	3,151	6,489	4,511	4,764	7,866	12,572	5.3
3 Ushqime, pije dhe duhan	4,263	2,460	2,024	2,479	1,165	5,477	5,562	10,389	10,708	4.5
27 Shërbime profesionale	749	1,755	6,062	6,688	1,696	3,001	3,610	5,136	6,710	2.8
24 Telekomunikacioni dhe transm. prog.	7,527	2,454	10,673	21,493	13,116	15,830	7,353	5,165	6,566	2.8
31 Shërbime të tjera	1,057	1,175	3,735	2,736	4,407	11,295	3,869	4,594	6,170	2.6
10 Metalet dhe produkte metalike	2,489	2,285	3,457	18,583	1,456	2,947	19,671	6,767	5,438	2.3
26 Aktivitete të pasurive të paluajtshme	551	7,614	6,522	2,918	1,267	2,019	2,931	2,788	5,246	2.2
21 Transporti	1,785	1,162	2,444	1,744	1,815	1,723	3,188	4,188	5,185	2.2
19 Akomodimi	2,104	944	695	157	498	1,588	2,280	3,819	4,751	2.0
30 Shëndetësia dhe aktiv. punës sociale	182	3,605	454	638	2,796	3,429	2,768	3,793	3,651	1.5
4 Tekstile dhe veshje	319	617	672	645	1,188	2,055	2,042	3,483	3,566	1.5
9 Produkte minerale jometalike	1,618	2,281	2,219	1,231	1,670	3,202	1,652	3,177	3,561	1.5
16 Tregtia dhe riparimi automjet.	602	1,388	481	1,010	1,391	2,354	1,557	2,590	3,387	1.4
5 Lëkurë dhe këpucë	601	472	905	1,375	1,009	3,424	2,641	2,838	3,199	1.3
20 Shërbimi ushqimor	963	841	1,775	1,770	783	712	2,699	2,149	2,961	1.2
8 Rafineria, In.kimike dhe plastike	1,459	767	702	1,802	592	1,189	3,307	1,717	2,718	1.1
22 Posta dhe magazinimi	3,003	12,140	4,836	1,598	5,332	7,032	3,437	3,303	2,677	1.1
14 Ujërat e zeza dhe trajtimi i mbetjeve	162	176	829	368	398	1,644	699	1,360	2,565	1.1
6 Druri, artik. me dru dhe mobilje	1,176	873	590	1,244	613	1,044	713	2,089	2,219	0.9
7 Letra dhe shtypshkrimet	212	544	324	627	2,038	1,398	1,809	1,816	1,701	0.7
28 Agjencitë e udhëtimeve	44	87	166	396	357	538	306	330	1,516	0.6
29 Arsimi	184	264	1,021	3,045	2,322	3,624	811	2,398	1,085	0.5
23 Aktv. publikimeve dhe prodh. prog.	1,088	544	9,356	1,018	190	792	266	245	687	0.3
11 In. të tjera përpunuese	41	13	54	486	109	462	1,470	851	431	0.2
25 Shërbime të informacionit	85	66	42	1,504	54	272	323	369	374	0.2

Burimi: Baza e të dhënave e INSTAT-it

Grafiku 12:
Investimet, sipas llojit, të gjithë prodhuesit në treg



Grafiku 13:
Struktura e investimeve dhe formimi i kapitalit fiks, sipas viteve të zgjedhura



Burimi: INSTAT-i, Eurostat-i, Institutet rajonale, Shqipëria për vitin 2018, të tjerat 2016


e organizative e, për pasojë, dhe burimi kryesor i rritjes së produktivitetit në ekonomi.

Sipas një analize krahasimore, Shqipëria investon 2–3 herë më pak në pajisje teknologjike se vendet e rajonit, ndërkohë që Serbia është vendi ku, nga pikëpamja

strukturore e një investimi, peshën më të madhe e zënë pajisjet teknologjike. Gjithashtu grafiku 13 nënvizon dhe një aspekt me rëndësi në strukturën e investimeve: pronësia intelektuale, që është burimi kryesor i inovacionit në vendet e rajonit, është gati tri herë më e ulët se në vendet e BE-së.


Grafiku 14:

Pasaporta teknologjike sipas vitit të prodhimit që raportohet nga biznesi, %



Grafiku 15:

Pasaporta teknike sipas vendit të origjinës



Ky rezultat që buron nga analiza e të dhënave në nivel ekonomie kombëtare, nuk përputhet plotësisht me të dhënat e siguruar nëpërmjet pyetësorit në nivel firme. Rezultatet e pyetësorit dëshmojnë se 64% e firmave të intervistuar raportojnë se pasaportat teknologjike janë të dekadës së fundit dhe rreth 95% e tyre raportojnë teknologji që datojnë pas vitit 2000. Po ashtu, rezulton se teknologjitë janë importuar prej vendeve të BE-së, të cilat karakterizohen nga teknologji të përparuara dhe të standardeve të larta.

Kjo gjetje surprizë dëshmon se problemi me produktivitetin nuk qëndron thjesht në paaftësinë e firmave për të investuar në teknologji të reja më produktive, por në faktin se firmat janë të pozicionuara në një segment biznesi ku vlera e shtuar, pavarësisht gatishmërisë teknologjike, është e ulët edhe në prodhimin e produkteve që nuk kërkojnë ndonjë shkallë të lartë sofistikimi.

Paradigma e biznesit duket se është ajo e prodhimit të një produkti tashmë të njohur, duke përsosur teknologjinë e prodhimit, por pa guxuar të eksperimentojë me zhvillim produktesh të reja ose ndoshta dhe me eksplorim të tregjeve të reja. Gjithashtu, struktura industriale e padiversifikuar lë pak vend për rritje të produktivitetit që duhet të burojë nga industritë me rritje më të shpejtë, që janë industritë e reja. “Bëj mirë atë që është e njohur” mund të jetë thjesht një strategji mbijetese për firmat, por jo një çelës për të arritur suksesin në afat të gjatë dhe, për më tepër, për të ndryshuar dinamikat për një rritje më të fortë të ekonomisë.

Studimet tregojnë se me të njëjtën sasi inputesh, pune dhe kapitali, disa vende, sektorë apo firma prodhojnë më shumë se disa të tjera. Diferencat shpjegohen me mënyrën se si alokohen dhe shfrytëzohen këto burime. Siç e cekëm në hyrje të këtij studimi, sipas teorisë klasike të ekonomisë, produktiviteti përcaktohet si rezidual i outputit që nuk shpjegohet nga kontributi i drejtpërdrejtë i përdorimit të inputit të burimeve (Solow, 1956)⁷.

Të dhënat e shumta në nivel firme në shkallë globale

dhe kërkimet empirike që janë mbështetur mbi to, kanë konfirmuar modelet e rritjes ekonomike dhe kanë çuar në gjetje të reja interesante. Kështu, rialokimi i inputeve në firmat inovative dhe në rritje, shpjegon më shumë se 50% të produktivitetit agregat në ekonomitë në zhvillim (Jorgenson, Ho dhe Stiroh (2010, 2014); Lentz dhe Mortensen (2005)). Prandaj dhe analizat mikro ofrojnë një vështrim më të saktë dhe të plotë mbi rolin e investimeve në rritjen e produktivitetit në nivel firme. Në mungesë të të dhënave të tilla, më poshtë po trajtojmë, bazuar në të dhënat dytësore, ndikimin e investimeve në produktivitet, duke dalluar sektorët ku janë shënuar më shumë investime ndaj atyre ku investimet kanë qenë të ulëta.

Analiza e mësipërme mbështet konkluzionin se investimet në rinovimin e stokut teknologjik kanë mbështetur përmirësimet në industritë ekzistuese, tradicionale dhe në pak industri të dominuara nga sipërmarrjet e huaja, siç janë shfrytëzimi i pasurive natyrore të vendit. Edhe në industritë e manufakturës, rinovimi i stokut teknologjik ka përmirësuar proceset e prodhimit në produktet ekzistuese dhe ka qenë i mjaftueshëm për të mbajtur bizneset në “lojën e tregut”, por nuk ka shenja që të ketë inkurajuar zhvendosjen e firmave drejt produkteve të reja më të sofistikuara. Janë pikërisht këto të fundit ku gjenerohen dhe normat më të larta të fitimeve dhe që udhëheqin edhe rritjen ekonomike në shkallë vendi.

Të dhënat e INSTAT-it provojnë se sektorët që kanë pasur më pak investime kanë ruajtur nivelet më të ulëta të produktivitetit⁸ në raport me produktivitetin total të ekonomisë dhe e kundërta për sektorët që kanë ruajtur norma relativisht të larta investimesh në teknologji. Siç dëshmohet nga të dhënat e tabelës 5, sektorët që kanë dhe peshën më të lartë në punësim dhe eksporte, përkatësisht industritë tekstile dhe veshje e lëkurë-këpucë, kanë pasur një nivel produktiviteti mjaft të ulët: gati në vetëm sa 30% e produktivitetit total në ekonomi. Për më tepër, në këta sektorë, gjendja relative e produktivitetit është përkeqësuar për gjithë periudhën e marrë në studim.

7 Solow, R. M. 1956. “A Contribution to the Theory of Economic Growth.” *The Quarterly Journal of Economics* 70 (1): 65–94. doi:10.2307/1884513.

8 Produktiviteti në këtë material është llogaritur nga raporti i vlerës së shtuar të sektorit me numrin e të punësuarve në sektor.

Tabela 5:

Investimet në teknologji dhe impakti në produktivitet

	Diferenca e produktivitetit të sektorit ndaj produktivitetit total të ekonomisë (=100%)	
	2010	2018
Sektorët ku është investuar më pak		
3 Ushqime, pije dhe duhan	-34%	-32%
4 Tekstile dhe veshje	-79%	-83%
5 Lëkurë dhe këpucë	-76%	-70%
6 Druri, artik.me dru dhe mobilje	-51%	-60%
7 Letra dhe shtypshkrimet	-33%	-20%
Sektorët ku është investuar më shumë:		
2 Industria nxjerrëse	15%	61%
9 Produkte minerale jometalike	34%	51%
10 Metalet dhe produkte metalike	27%	85%
12 Energjia elektrike dhe gazi	107%	195%

Burimi: Autorët, llogaritur me të dhënat e bazës së të dhënave të INSTAT-it

5

A INVESTOJNË FIRMAT LOKALE NË TEKNOLOGJI MË TË PËRPARUARA PËR TË REALIZUAR PRODUKTE E SHËRBIME MË TË SOFISTIKUARA DHE KOMPLEKSE?


Kjo ishte dhe pyetja jonë kërkimore themelore dhe, nga perspektiva e politikave publike, ajo është thelbësore. Studimi i CID-it që cituam, nënvizon si shkakun kryesor faktorët kulturorë, të trashëgimisë historike. Sektori privat shqiptar, i krijuar pas rënies së komunizmit, u angazhua në veprimtari që njiheshin dhe më parë, si bujqësi, ndërtim, miniera dhe aktivitete të tjera të ndryshme, që nuk kërkonin ndonjë shkallë të lartë sofistikimi. Fatkeqësisht, me përjashtime të parëndësishme, gjendja nuk ka ndryshuar edhe pas gati tri dekadash tranzicioni drejt sistemit të ekonomisë së tregut. Disa industri të dominuara nga investimet e huaja kanë pasur më shumë sukses në tregjet e huaja, e po ashtu dhe disa industri lokale (kryesisht

vaji i ullirit dhe përpunimi i mishit) të mbështetura nga donatorët (kryesisht USAID-i dhe GIZ-i). Segmentet e tjera të industrive lokale kanë mbetur të pazhvilluara. Po kështu, edhe investimet e huaja kanë qenë aktive në sektorët e shërbimeve (financë, telekomunikacion) dhe të shfrytëzimit të pasurive të nëntokës (krom, naftë, bakër, çimento). Episode pozitive vërehen nga iniciativat sipërmarrëse të emigrantëve të rikthyer, të cilët punojnë me tregjet e vendeve ku kanë qenë të emigruar.

Nëpërmjet analizës së pyetësorit jemi përpjekur të hedhim më shumë dritë mbi këtë temë, për të kuptuar disa nga shkaqet përse firmat shqiptare nuk e shohin si


Grafiku 16:

Zëvendësimi teknologjik sipas eksperiencës së firmave



Grafiku 17:

Arsyet përse firmat nuk kanë bërë përpjekje për zëvendësim teknologjik



domosdoshmëri investimin në zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve më të sofistikuar, kërkimin e tregjeve të reja për eksport dhe integrimin më të mirë në zinxhirin global prodhues.


Rezultatet e pyetësorit dëshmojnë se 66% e firmave kanë kryer zëvendësime të teknologjive. Kjo dëshmon se ka një ndërgjegjësim në sektorin privat mbi rolin që luajnë

teknologjitë e reja në zgjerimin e aktivitetit ekonomik të firmës.

Midis firmave që nuk kanë zbatuar ndryshime teknologjike, vetëm 11% e tyre dëshmojnë se nuk ekzistojnë alternativa më të mira, çka do të thotë se mundësitë për rritje të produktivitetit nëpërmjet përmirësimeve teknologjike janë të mëdha.


Grafiku 18:

Problematika që has biznesi në aspektin e zbatimit të teknologjive



Grafiku 19:

Përshtatshmëria e burimeve njerëzore me teknologjinë në përdorim



Argumenti i mungesës së financimeve është një nga kufizimet kryesore. Ndërsa fakti se pothuajse gjysma e bizneseve nuk shfaqin asnjë interes për të ndryshuar teknologjinë është pikërisht fenomeni shqetësues nga pikëpamja kulturore e biznesit. Kontrolli i këtyre dy faktorëve kërkon politika dhe ndërhyrje të veçanta.


Me pritshmërinë se një barrierë për investimet në teknologji më të sofistikuar mund të ishte mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar, pyetësori ka hedhur dritë

mbi këtë kufizim potencial. Por rezulton se në vetëm 17% të rasteve firmat kanë ndeshur në vështirësi ekspertize. Inxhinierët dhe stafet teknike duket se kanë kualifikimet e duhura për operimin e teknologjive dhe mirëmbajtjen e tyre.

Pavarësisht se firmat raportojnë se kanë investuar në rinovim teknologjik, teknologjitë e reja dhe inovacionet në produkte të reja janë gjerësisht të dëshiruara prej tyre. 2 në 3 firma pohojnë se zhvillimi i produkteve të reja dhe

Grafiku 20:

Drejtimit në të cilat firmat besojnë se është më me interes të investohet



investimet në teknologji janë prioritet i tyre. Gjithashtu, me rëndësi mbeten edhe zhvillimi i tregjeve të reja dhe përmirësimi i produkteve aktuale. Ndërsa investimi në kualifikimin e fuqisë punëtore konsiderohet ndër faktorët e fundit prioritarë për investime. Ky është një moskuptim serioz i prioriteteve të investimeve të firmave vendase, ndërkohë që fuqia punëtore e kualifikuar është dhe një nga burimet kryesore të inovacionit të produkteve dhe proceseve të prodhimit dhe rritjes së produktivitetit në tërësi.

Analiza e mësipërme dëshmon se, bazuar në perceptimet e vetë biznesit, (a) segmente të rëndësishme të industrive janë të interesuara të investojnë në teknologji të reja

dhe po ashtu në zhvillimin e produkteve të reja. Por, (b) mungesa e aksesit në financime konsiderohet si një faktor pengues. Ndërsa investimet në teknologji dhe zhvillim produktesh janë prioritare, (c) investimet në burime njerëzore nuk konsiderohen si njësoj të rëndësishme. Ndërkohë, mungesa e investimeve në zhvillimin e burimeve njerëzore është dhe një nga shkaqet kryesore të paaftësisë së firmave për inovacion dhe zhvillim produktesh. Shqetësues është gjithashtu fakti se (d) një segment shumë i gjerë i biznesit nuk është i interesuar të investojë në teknologji të reja. Ky segment duket se është i kënaqur me situatën e një biznesi që ruan statukuonë, pa u interesuar të ndryshojë dinamikat e prodhimit dhe të tregjeve në të cilat punon.

6

POLITIKAT PUBLIKE TË DERISOTME NË MBËSHTETJE TË TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJISË DHE TË ASISTENCËS SË BIZNESIT NË INOVACION

Mbështetja buxhetore me fondet publike për të ndihmuar sipërmarrjet në rritjen e konkurrueshmërisë realizohet me anën e këtyre projekteve:

- Fondi i konkurrueshmërisë, krijuar në vitin 2013;
- Fondi i ekonomisë kreative, miratuar në vitin 2011, kryesisht për asistencën ndaj ndërmarrjeve të artizanatit;
- Fondi i *start-up*-eve, krijuar në vitin 2014;
- Fondi i inovacionit, krijuar në vitin 2011.

Të gjitha këto skema synojnë të mbështetin sipërmarrjet private me bashkëfinancim (deri në 70% të kostove) me një shumë që shkon në rreth 5,000 euro për zhvillim tregu, transferim teknologjie, inovacion etj. Në një botim statistikor të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ([https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/botim_statistikor_fondet_\(2\).pdf](https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/botim_statistikor_fondet_(2).pdf)) rezulton se për gjithë periudhën 2014–2019, janë disbursuar gjithsej më pak se 2 milionë euro për rreth 360 firma përfutuese, me një shumë mesatare përfitim prej 5,000 eurosh, sa tavan i ligjor i lejuar për përfitim.

Duke krahasuar eksperiencat e vendeve të rajonit në mbështetjen që politikat publike ofrojnë për inovacionin në biznes, ne kemi marrë si një nga praktikatat e mira eksperiencën e Serbisë. Nëpërmjet Fondit të Inovacionit, të krijuar që prej vitit 2011, janë financuar rreth 695 projekte me një fond prej 24 milionë eurosh (deri në momentin e shkrimit të këtij materiali). Shkalla e mbështetjes shkon deri në 80 mijë euro për biznes, dhe biznesi privat duhet të bashkëfinancojë të paktën 30% të investimit. Impakti i projekteve të administruara me anën e kësaj skeme duket se ka qenë i dukshëm dhe konkret për firmat përfutuese (<http://www.inovacionifond.rs/fond/about-fund>).

Maqedonia e Veriut gjithashtu ka krijuar që në vitin 2013 një Fond për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik, ku janë financuar një numër projektesh të reja dhe që mbështetin

inovacionin dhe komercializimin e teknologjisë. Në faqen në internet gjenden informacione të plota mbi projektet dhe rezultatet e arritura nga Fondi (<https://fitr.mk>).

AIDA është gjithashtu koordinatore e disa projekteve të financuara nga BE-ja, siç janë:

- Projekti i Rrjetit European të Ndërmarrjeve (*Enterprise Europe Network*). Ikona “histori suksesi” e *site*-t (<https://een.al/?lang=sq>) nuk rezulton aktive dhe raportet që gjenden në *site*-n përkatës referohen vetëm me një numër vizitash në disa biznese, por pa referuar përfitimet e marra nga ky projekt i nisur që në vitin 2018.
- Projekti FILA (*Fertilization Innovation Labs in Agro-food*), me një buxhet prej 1 milion eurosh, që synonte të mbështeste sipërmarrjet bujqësore në Shqipëri (Korçë), Mal të Zi dhe Itali (Bari), duket se ka kontribuar vetëm me disa seminare dhe nuk rezulton të ketë ndonjë produkt të prekshëm për Shqipërinë. Ndërkohë, Mali i Zi përfitoi një printer 3D, që u përdor edhe për qëllime printimi të mjeteve mbrojtëse ndaj COVID-19-s.
- Projekti “Blue Boost”: rezultatet e tij janë një numër seminaresh dhe aktiviteteve trajnuese, por pa inpute të prekshme.
- Projekti european COSME (*Competitiveness of Small and Medium-sized Enterprises*), projekti më i rëndësishëm për rritjen e konkurrueshmërisë së SME-ve, me një financim prej 2.3 miliardë eurosh për periudhën 2014–2020. Fushat e mbështetjes nëpërmjet këtij projekti përfshijnë:
 - Aksesin në financë;
 - Mbështetjen për ndërkombëtarizim dhe akses në tregje;
 - Krijimin e një mjedisi të favorshëm për konkurrueshmërinë;
 - Inkurajimin e kulturës së sipërmarrjes.

Nuk ka ndonjë informacion për firmat shqiptare që mund të kenë qenë përfituese të këtij projekti.

dh. Lehtësia për inovacion dhe zhvillim të sipërmarrjes në Ballkanin Perëndimor (*Western Balkans Enterprise Development and Innovation Facility*, WB EDIF). Referuar burimeve të internetit, teksa për vendet e tjera të rajonit jepet informacion mbi raste studimore dhe modele të sjella si shembuj, për Shqipërinë nuk gjendet asnjë e dhënë. Ky program ka të nënshkruar marrëveshje për garantim kredie me bankën "Procredit" në fazën e parë dhe me bankën "Raiffeisen" në fazën e dytë, por në faqet e internetit të bankave nuk gjendet asnjë informacion për projektin dhe se çfarë lehtësish ofron ai për biznesin.

Problemi me mekanizmat mbështetës financiarë për të mbështetur inovacionin, transferimin e teknologjive

dhe sofistikimin e bizneseve është se fondet e vëna në dispozicion janë shumë të pakta (mesatarisht 400 mijë euro në vit) dhe skemat nuk duket të jenë hartuar në mënyrë që të luajnë një rol të ndjeshëm në përmbushjen e objektivave të caktuar. Duket qartë se nevojitet një rishikim tërësor i këtyre skemave, të cilat mund të shkrihen në një fond të vetëm dhe me prioritet të rishikuara, duke u orientuar drejt mbështetjes së përpjekjeve për automatizim dhe digjitalizim të operacioneve të kompanive shqiptare, si dhe drejt mbështetjes së firmave shqiptare me ekspertizë të huaj, të kualifikuar për rishikimin e politikave të zhvillimit të produkteve dhe mundësive për zhvillim të produkteve të reja. Kjo mund të rezultojë edhe në riorganizim të sipërmarrjeve dhe futjen e praktikave të reja menaxheriale, të cilat mund të kenë ndikime të rëndësishme në rritjen e produktivitetit të tyre në të ardhmen.

7

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Ky studim kishte si objektiv themelor shqyrtimin e arsyeve kryesore përse biznesi privat prodhues lokal ka mbetur i ngërthyer në një nivel modest të produktivitetit të ekonomisë, që mund të jetë pasojë e niveleve të ulëta të investimeve në teknologji dhe kapital njerëzor dhe e eficientës me të cilën përdoren këto burime të kufizuara ekonomike. Gjendja e dobët e produktivitetit dëshmohet nga treguesit e ulët të konkurrueshmërisë së ekonomisë, veçanërisht në dimensionet e lidhura me sofistikimin e biznesit, kulturën e biznesit dhe aktivitetet e kërkim-zhvillimit. Po kështu, Indeksi i Komplexitetit Ekonomik e Rendit Shqipërinë disa shkallë më poshtë se vendet e rajonit, duke dëshmuar se vendi ka një mungesë të theksuar të dijës produktive, që përbën dhe faktorin kryesor të rritjes ekonomike nëpërmjet zhvillimit të produkteve dhe sektorëve të rinj.

Gjatë tri dekadave të tranzicionit, vendi ka investuar burime të rëndësishme financiare në importimin e makinerive dhe pajisjeve, kryesisht me origjinë nga vendet e zhvilluara të Bashkimit Europian. Biznesi shqiptar është relativisht i ri dhe, për pasojë, edhe teknologjitë në pjesën më të madhe i përkasin periudhës pas viteve 2000. Megjithatë, evidentohet qartë se:

- a. Pësia më e madhe e investimeve në teknologji ka shkuar vetëm në sektorët tradicionalë dhe për prodhimin e produkteve tradicionale. Investimet nuk e kanë transformuar strukturën prodhuese të vendit dhe kalimin drejt industrive të niveleve të larta të vlerës së shtuar dhe produktivitetit të lartë.
- b. Investimet në sektorët e industrisë nxjerrëse, metaleve dhe të energjisë elektrike u dedikohen politikave aktive qeveritare për të mbështetur kapitalin privat, veçanërisht atë të huaj, në këta sektorë. Ndikimi i investimeve në këta sektorë është i qartë teksa krahasojmë diferencat e produktivitetit në ta dhe në sektorët ku është investuar më pak (lëkurë-këpucë, tekstile etj.) në raport me nivelin mesatar të produktivitetit të ekonomisë. Sektorët me më shumë investime në teknologji kanë treguar një nivel produktiviteti prej 50% deri në dy herë më të lartë se niveli mesatar i produktivitetit të ekonomisë. Ndërsa në sektorët ku ka pasur më pak investime, produktiviteti qëndron rreth 30-80% më i ulët se produktiviteti mesatar i ekonomisë. Kjo do të

thotë se investimi shpërblen dhe se është në interes të firmave që dëshirojnë të sigurojnë norma më të larta fitimi të angazhohen në një proces investimesh modernizuese të teknologjisë dhe dijës.

- c. Anketimet tregojnë se vetë biznesi është i ndarë për sa i takon interesit investues për të qenë më konkurrues në tregje. Dy drejtimit kryesore të investimeve që ata shohin me prioritet janë investimet në teknologji të reja dhe në zhvillim produktesh të reja. Problemi kryesor që ata evidentojnë në pamundësinë për investime lidhet me aksesin në financa.
- d. Shqetësuese janë dy gjetje të studimit:
 - (i) investimet në burime njerëzore nuk konsiderohen po aq të rëndësishme sa ato në teknologji dhe në zhvillim produktesh. Ndërkohë në debatet e përditshme mediatike nënvizohet se mungesa e burimeve njerëzore të kualifikuara është dhe një nga pengesat kryesore të biznesit.
 - (ii) një segment shumë i gjerë i biznesit nuk është i interesuar të investojë në teknologji të reja. Ky segment duket se është i kënaqur me situatën e një biznesi që ruan statukuonë, pa u interesuar të ndryshojë dinamikat e prodhimit dhe të tregjeve në të cilat punon.

Këto dy shqetësime të konstatuara nga studimi, konfirmojnë se problemi i konkurrueshmërisë së ekonomisë është një problem sa kulturor, po aq edhe financiar.

Edhe pse qeveria shqiptare ka filluar që në vitet 2011 të krijojë skema të mbështetjes publike për firmat e interesuara të rritin konkurrueshmërinë e tyre nëpërmjet zhvillimit të produkteve dhe tregjeve të reja, fondet buxhetore të alokuara kanë qenë tepër të ulëta: më pak se 2 milionë euro për gjithë periudhën 2014–2019. Për më tepër, shuma e mbështetjes është minimale, prej deri në 5,000 euro për aplikant, çka mbulon vetëm shpenzimet minimale të kërkimit të tregjeve.

Pandemia e COVID-19-s tregoi se firmat që kishin një nivel të lartë automatizimi të proceseve të prodhimit dhe digjitalizim të shërbimeve, u ndikuan në mënyrë shumë pjesore nga mbyllja e aktiviteteve ekonomike. Ky aksident historik e ka rritur ndërjegjësimin midis komunitetit të

biznesit për nevojën e investimeve më të rëndësishme në digjitalizim dhe automatizim të sistemeve të prodhimit dhe tregtimit.

Është pikërisht momenti i duhur që politika industriale për vitet e ardhshme të fokusojë pikërisht këta komponentë të investimeve. Më specifikisht, do të ishte e rekomandueshme që:

1. Të gjitha politikat publike mbështetëse dhe incentivuese të synojnë objektiva cilësorë për sa i përket nivelit teknologjik, duke hequr dorë nga objektivat sasiorë që lidhen me vëllime investimesh apo numër të punësuarish. Në mënyrë më specifike, legjislacioni për investimet e huaja strategjike, por edhe ligjet për promovimin e *start-up*-eve dhe transferimin e teknologjisë, duhet të vendosin si objektiva: (a) shkallën e automatizimit të proceseve të prodhimit, duke e kushtëzuar çdo përfitim publik me paraqitjen e certifikatave teknologjike që dëshmojnë se janë të gjeneratës së fundit; (b) digjitalizimin e proceseve të prodhimit dhe tregtimit të bizneseve; (c) investimin në burimet njerëzore dhe rritjen e *know-how*-t teknologjik; (d) teknologjia të respektojë standardet mjedisore më të larta që zbatohen sot në vendet e Bashkimit Europian.
2. Përzgjedhja e firmave që realizojnë vepra me fondet publike të kryhet mbi bazën e kriterëve që renditëm më sipër. Në veçanti, fokusi kryesor në këto projekte të jenë investimet në kapitalin njerëzor të vendit, në mënyrë që të sigurohet transferimi i dijes te forca punëtore e vendit. Por pjesë e kriterëve përzgjedhëse të jenë edhe politikat e pagave dhe shpërblimit të punës, kushtet e punës dhe përgjegjësia sociale e korporatës.
3. AIDA, që administron fondet publike të mbështetjes për inovacion dhe zhvillim të tregjeve dhe produkteve, të ketë një buxhet të konsiderueshëm për të realizuar këtë mision madhor të modernizimit të ekonomisë. Një fond investimi prej të paktën 10 milionë eurosh të jetë i disponueshëm në çdo vit buxhetor për të mbështetur firmat vendase që kanë projekte të qarta dhe që demonstrojnë kapacitete të disponueshme për të përmbushur objektivat e tyre në këto fusha. Skema të ofrojë grante në të paktën 50% të kostove të teknologjisë apo proceseve të digjitalizimit në të gjithë sektorët e ekonomisë, me një shumë maksimale përfitimi deri në 50 mijë euro, duke u bërë të krahasueshëm me Serbinë.
4. Qeveria shqiptare, nëpërmjet AIDA-s, t'u ofrojë asistencë teknike falas industrive me potenciale zhvillimore në diagnostikimin e portofolit të produkteve ekzistuese, tregjeve dhe praktikave të marketimit të tyre, duke synuar të identifikohen përmirësimet e produkteve ekzistuese apo të gjenerohen ide për zhvillimin e produkteve të reja, si dhe të tregjeve më fitimprurëse.
5. Një mënyrë alternative do të ishte ofrimi i fondeve në bashkëfinancim me donatorët të cilët kanë dëshmuar eksperiencën të suksesshme deri më tani. Projekte të tilla të suksesshme janë evidentuar nga GIZ-i dhe USAID-i. Vënia e fondeve publike në dispozicion të donatorëve me eksperiencë suksesi të dallueshëm do të rriste ndjeshëm efektivitetin e përdorimit të fondeve publike, si dhe transparencën e tyre.

LITERATURA MBËSHTETËSE

Acemoglu, Daron, Simon Johnson dhe James Robinson (2004): *Institutions as the Fundamental Cause of Long-Run Growth, 10481*. NBER Working Paper.

Alistair, Dieppe (2020): *Global Productivity: Trends, Drivers, Policies*, World Bank.

Dale W. Jorgenson, Mun Ho dhe Jon Samuels (2010): *INFORMATION TECHNOLOGY AND U.S. PRODUCTIVITY GROWTH: Evidence from a Prototype Industry Production Account*, Prepared for Industrial Productivity in Europe: Growth and Crisis, Matilde Mas and Robert Stehrer (eds.)
(2014): *Long-term Estimates of U.S. Productivity and Growth, Growth and Stagnation in the World Economy*, Tokyo.

Easterly, William dhe Ross, Levine (2003): *Tropics, Germs, and Crops: How Endowments Influence Economic Development*, Journal of Monetary Economics. doi:10.1016/S0304-3932(02)00200-3.

Hall, Robert E. dhe Charles I. Jones (1999): *Why Do Some Countries Produce so Much More Output per Worker than Others?* Quarterly Journal of Economics 114 (1): 83–116. doi:10.1162/003355399555954.

Rasmus Lentz Dale T. Mortensen (2005): *AN EMPIRICAL MODEL OF GROWTH THROUGH PRODUCT INNOVATION*, NBER WORKING PAPER SERIES, 11546

Rodrik, Dani, Arvind Subramanian dhe Francesco Trebbi (2004): *Institutions Rule: The Primacy Over in Economic and Integration Geography Development*, Journal of Economic Growth 9 (2): 131–65.

Solow, R. M. (1956): *A Contribution to the Theory of Economic Growth* The Quarterly Journal of Economics 70 (1): 65–94. doi:10.2307/1884513.

Tim O'Brien et al. (2017): *What is the Binding Constraint to Growth in Albania?* Center for International Development, Harvard University.

World Economic Forum (2019): *Global Competitiveness Report*.

Young Eun Kim, Norman V. Loayza (2017): *Productivity and its Determinants: Innovation, Education, Efficiency, Infrastructure, and Institutions*, World Bank working paper.


ANEKSI 1: TË DHËNA PËR POPULLATËN E INTERVISTUAR

Janë përzgjedhur në mënyrë rastësore 121 firma në aktivitetet prodhuese të manufakturës (bazuar në NACE-Rev2), sipas strukturës së paraqitur në grafikun 1 më poshtë, dhe firma relativisht të mëdha, të cilat kanë kapacitetet e nevojshme financiare për investime


në teknologji dhe inovacion. Në mënyrë të qëllimshme janë përzgjedhur firmat me pronësi shqiptare, pasi ky është dhe synimi i punimit. Diferencat ndërmjet firmave shqiptare dhe atyre të huaja janë evidentuar në shumë studime të tjera.

Grafiku 1:

Cila është fusha e veprimtarisë së kompanisë? (Sipas kategorisë, ndarja në NACE_Rev_2)



Madhësia e firmave të intervistuar:



ANEKSI 1: PYETËSORI

1. Identiteti i kompanisë:

- a. viti i krijimit;
- b. fusha e veprimtarisë;
- c. numri i punonjësve;
- d. pronësia (shqiptare/e huaj/*joint venture*).

2. Ecuria e aktivitetit ekonomik:

- a. Si kanë qenë dinamikat e kompanisë gjatë pesë viteve të fundit:

	deri 10%	10%–20%	mbi 20%
Shitjet (+/-)			
Fitimet (+/-)			
Punësimi (+/-)			

- b. Cilat janë pritshmëritë tuaja për pesë vitet e ardhshme?

	deri 10%	10%–20%	mbi 20%
Shitjet (+/-)			
Fitimet (+/-)			
Punësimi (+/-)			

- c. Cili ka qenë efekti i pandemisë në të tre këta tregues?

3. Tregu i furnizimit dhe prodhimit: Ndërlidhja në zinxhirin global prodhim/furnizim

- a. Tregu i furnizimit me lëndë të para:

- i. vendas;
- ii. jashtëm (specifiko vendin/vendet) _____.

- b. Nëse furnizimi me lëndë të para kryhet nga jashtë, kjo sepse:

- i. ato mungojnë në tregun vendas;
- ii. ka vështirësi në organizimin e furnitorëve të brendshëm.

nëse (ii), jeni të lutur të specifikoni vështirësinë që ndeshni.

- c. Tregu i shitjes së prodhimit të gatshëm:

- i. vendas;
- ii. jashtëm (specifikoni vendin/vendet) _____.

- d. Si jeni vënë në kontakt me tregjet e furnizimit me lëndë të parë dhe të shitjeve?

- i. Nëpërmjet njohjeve personale me biznesmenë të huaj;
- ii. Nëpërmjet përdorimit të teknologjive të informacionit (internet apo forma të tjera të medias sociale);
- iii. Nëpërmjet kërkimeve dhe studimeve të porositura nga agjenci marketingu apo të kërkimeve të tregjeve.

- e. A zbatojnë firmat ndonje formë të "*trade finance-s*"? (për shembull: shitje me kredi apo blerje me kredi...)

- i. Në shitje të prodhimeve;
- ii. Në blerje të lëndës së parë.

- f. Çfarë ndikimi pati pandemia në zinxhirin tuaj të biznesit (furnizim dhe shitje)?

- i. Mendoni të ruani të njëjtët klientë dhe furnitorë?
- ii. Keni filluar të mendoni të ndryshoni furnitorët?

4. Investimet në teknologji:
- a. Çfarë pasaporte teknologjike përdor firma juaj?
 - i. viti i prodhimit;
 - ii. vendi i origjinës;
 - iii. viti kur është blerë;
 - iv. ka qenë e re apo e përdorur?
 - v. çfarë teknologjie përdor sot kjo industri në botë?
 - vi. Nëse firma nuk i përdor këto teknologji të reja, çfarë e pengon adoptimin e tyre:
 - vështirësitë financiare
 - mungesa e njohurive për përdorimin e tyre
 - faktorë të tjerë_____
 - b. Nëse firma do t'i zbatonte këto teknologji, sa do të rritej produktiviteti i firmës suaj (prodhimi për punëtor)?
 - i. rritje me 10%..., 25%..., 50%;
 - ii. dyfishim...?
 - c. A ka bërë firma ndonjëherë përpjekje për ndryshim të teknologjisë së prodhimit që nga fillimi i aktivitetit?
 - d. Nëse po dhe pa rezultat, cilat kanë qenë arsyet e dështimit? Nëse jo, për çfarë motivesh?
 - i. Mjafton vëllimi i aktivitetit/fitimit që keni;
 - ii. Ka më shumë kokëçarje në raport me fitimet shtesë;
 - iii. Probleme me kualifikimin e punëtorëve.
 - e. Nëse keni pasur probleme teknike në funksionimin e linjave të prodhimit, a ka qenë e lehtë të gjenit inxhinier apo staf teknik për riparim?
 - f. I keni gjetur brenda vendit apo jashtë?
 - g. Keni lidhje afatgjata (kontrata shërbimi) me firmat inxhinierike për garantimin e teknologjisë?
 - h. Nëse do të kishit pasur një teknologji të caktuar, a do të ishit ndikuar më pak nga kriza e pandemisë?
 - i. Nëse po, mendoni se do ta ndryshoni teknologjinë tuaj me investime të reja?
5. *Know-how*:
- a. Çfarë niveli arsimor kanë punëtorët që përdorin teknologjinë?
 - i. Nivel të mesëm/të lartë/profesional...
 - ii. Sa e zoterojnë ata teknologjinë që përdorin? Shumë mirë - mirë - disi
 - iii. A kanë vizituar ata ndonjëherë ndonjë fabrikë që prodhon teknologji? Po/Jo
 - iv. A janë zhvilluar kualifikime për ta nga stafe të huaja apo vendase? Po/Jo
6. Nëse do të synonit ta zgjeronit edhe më shumë aktivitetin tuaj, ku mendoni se do të ishte më me interes investimi:
- a. Në teknologji?
 - b. Në trajnimin e punëtorëve?
 - c. Në zhvillimin e tregjeve të reja?
 - d. Në produkte të reja apo inovacion në produktet ekzistuese?
 - e. Në riorganizimin e prodhimit?
7. A ka firma juaj një certifikatë të njohur ndërkombëtare të cilësisë së produkteve/shërbimeve tuaja? Nëse po, jeni të lutur të specifikoni llojin e certifikatës.

MBI AUTORËT

Prof.As.Dr. Selami Xhepa

Mban titullin “Profesor i Asociuar” në shkencat ekonomike dhe është Presidenti i Universitetit European të Tiranës. Përveç karrierës akademike dhe angazhimit profesional në disa institucione të ndryshme, duke përfshirë detyrën si Kryeekonomist në Departamentin e Kërkimeve dhe Politikës Monetare në Bankën e Shqipërisë dhe Drejtues Kërkimesh në Qendrën për Tregtinë Ndërkombëtare, Dr. Xhepa ka mbajtur edhe poste administrative. Ai ka shërbyer si Drejtues Ekzekutiv i Agjencisë së Investimeve të Huaja, Këshilltar për politikat ekonomike pranë Kryeministrit dhe anëtar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave në Kuvendin e Shqipërisë. Interesat kërkimorë përfshijnë fushat e ekonomisë ndërkombëtare dhe të zhvillimit.

Ornela Liperi

Ornela Liperi është kryeredaktore e Revistës “Monitor”, e vetmja e përjavshme e specializuar për ekonomi në vend. Ajo ka përfunduar studimet e larta në Universitetin e Tiranës në degën menaxhim-marketing. Ka përfunduar MBA-në pranë Universitetit Politeknik, në bashkëpunim me Universitetin e Bordosë, Francë, si dhe ka kryer një trajnim akademik pranë Universitetit të Oksfordit, Mbretëri e Bashkuar. Është autore e artikujve të shumtë për financat, ekonominë, sistemin bankar etj.

IMPRINT

Fondacioni “Friedrich Ebert” | Rr. “Kajo Karafili”, Nd. 14, Hyrja 2, Kati 1 | Tiranë | Shqipëri

Përgjegjës:

Stine Klapper | Drejtoreshë e Fondacionit “Friedrich Ebert”, Zyra e Tiranës

Tel: +355 4 22 509 86 / 733 06

www.fes-tirana.org

Menaxhere Programi:

Jonida Smaja

Redaktore letrare:

Edlira Shuli

Realizimi i sondazhit:

Media Union

Përdorimi tregtar i të gjitha materialeve mediatike të publikuara nga Fondacioni «Friedrich-Ebert» (FES) nuk lejohet pa pëlqimin me shkrim të FES-it.

PRODUKTIVITETI: THEMBRA E AKILIT E EKONOMISË SHQIPTARE



Ky studim ka si qëllim të hetojë mbi problematikën e produktivitetit të ekonomisë së vendit dhe politikat më të përshtatshme që mund të ndikojnë në rritjen e tij. Vëmendja e autorëve është përqendruar në arsyet kryesore përse biznesi privat prodhues lokal ka mbetur i ngërthyer në një nivel modest produktiviteti.



Për analizën janë shfrytëzuar të dhënat parësore të grumbulluara nëpërmjet anketimit të biznesit prodhues dhe të dhënat dytësore të disponueshme.

Ndër gjetjet kryesore të punimit, si shqetësuese cilësohen dy prej tyre: (i) investimet në burime njerëzore nuk konsiderohen po aq



të rëndësishme sa ato në teknologji dhe në zhvillim produktesh; (ii) një segment shumë i gjerë i biznesit nuk është i interesuar të investojë në teknologji të reja. Këto konstatime konfirmojnë se problemi i konkurrueshmërisë së ekonomisë është një problem sa kulturor, po aq edhe financiar.

Për më shumë informacion:

<https://www.fes-tirana.org/al/publikime/>